



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues i Senatit**  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1599 Dt 08.07.2022

Senati i Universitetit "Isa Boletini në Mitrovicë, bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenin 166, paragrafin 4 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 dt. 30.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe Rregullores nr. 1667, dt. 28.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, në mbledhjen e mbajtur më 07.07.2022, mori:

**VENDIM**

1. Për shpalljen e konkursit për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, sipas propozimeve të njësisve akademike.
2. Konkursi për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik do të hartohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 dt. 30.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe Rregullores nr. 1667, dt. 28.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM.
3. Përgjashtimisht, nenit 16, pika 15 të Rregullores nr. 1667, dt. 28.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, për këtë konkurs, dorëzimi i raporteve vlerësuese nga komisionet vlerësuese do të bëhet më 23.08.2022-24-08.2022. Afatet në vazhdim të procesit të rekrutimit mbesin të pandryshuara dhe rrjedhin prej momentit të dorëzimit të raporteve nga komisionet vlerësuese, por pa e kaluar periudhën prej 175 ditësh nga dita e shpalljes.
4. Konkursi do të publikohet në web-faqen zyrtare të Universitetit.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Senati i Universitetit, duke pasur parasysh se, stafi i UIBM është në pushim kolektiv, e konsideroi të arsyeshme që periudha e hartimit të raporteve nga komisionet vlerësuese, të shtyhet si në pikën 3 të dispozitivit të vendimit, me qëllim që stafit të mos u mohohet e drejta e shfrytëzimit të pushimit kolektiv, por pa e cënuar edhe afatin prej 175 ditësh (neni 19, pika. 4, të Rregullores nr. 1667, dt. 28.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM).

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Menaxhmentit;
3. Fakulteteve;
4. Zyrës së personelit
5. Zyrës për çështje akademike
6. Zyrës për informim me publikun

  
Prof. dr. Alush Musaj  
Kryesues i Senatit

Rr. (St.)Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1